



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



## **E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes inauguruese të Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural, mbajtur më  
29.07.2022, duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Komitetit: Muhamet Selmani, Feim Osmani, Driton Rukiqi, Rashit Gashi dhe Besë Prestreshi, eksperte e jashtme.**

Mbledhjen e hapi Muhamet Selmani, me këtë

### **REND TË DITËS:**

- 1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural;**
- 2. Të ndryshme.**

**Muhamet Selmani** i përshëndeti të pranishmit, duke thënë se sot në këtë takim jemi për zgjedhjen e kryesuesit të Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural. Do ta bëjmë propozimin e njërit prej anëtarëve të komitetit për kryesues të Komitetit dhe do ta votojmë.

E hodhi në votim zgjedhjen e kryesuesit të Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural.

Me vota unanime u zgjodh Muhamet Selmani, kryesues i Komitetit për bujqësi dhe zhvillim rural dhe do të përfaqësojë këtë komitet deri në fund të këtij mandati.

Në mungesë të kryesuesit të Komitetit, atë do ta zëvendësojë zëvendëskryesuesi, andaj po e zgjedhim edhe një anëtar si zëvendëskryesues.

E hodhi në votim zgjedhjen e zëvendëskryesuesit.

Me vota unanime Feim Osmani zgjidhet zëvendëskryesues i Komitetit.

Kryesuesi propozoi që bashkërisht anëtarët e komitetit të punojnë në hartimin e planit të punës për këtë vit dhe vitin e ardhshëm. Pra, të fokusohemi kryesisht në planin e punës së Kuvendit dhe sa më shpejt do ta kemi një takim me Drejtorinë e Bujqësisë, me i koordinuar aktivitetet bashkërisht dhe me bërë Planin e punës, ku secili nga ne si përfaqësues me qenë aktiv dhe me pa qëllimin ku e kemi për zhvillim rural, dhe në takimin e radhës me i renditur te pjesa e punës, në mënyrë që me i shtyrë përpara ose me i ndarë në fusha, dikush me u marrë me ujtje, tjetri me vreshta etj., me i ndarë në fusha.



**Feim Osmani** tha se ne nuk jemi krejtësisht profesionistë në këtë drejtim thuajse asnjëri, posaçërisht në fusha të veçanta, andaj mundemi të jemi laikë në këtë aspekte, andaj unë po mendoj se ne duhet me përcjellë punën e Kuvendit, punën e drejtorisë, dhe me insistuar me ia përshtatur agjendës që ne e krijojmë. Kjo duhet të jetë si ndihmë e drejtorisë, jo si aspekt teknik, se nuk mundemi me ndikuar teknikisht, por politikisht mundemi me ndikuar në agjendë të drejtorisë dhe ekzekutivi i Komunës së Prishtinës. Pra ne duhet me iu përshtatur orarit të Kuvendit, por duhet me i paraprirë me politika zhvillimore për shkaku që me marrë si shtytje drejtoria për me ndikuar në zhvillimin e bujqësisë.

Mendoj se si pikë e parë që ne duhet trajtuar do të duhej insistuar në seancën e shtatorit me raportuar për përgatitjet për mbjelljet vjeshtore, për mos me na ndodhur edhe një herë mbas përfundimit të fushatës së mbjelljeve me diskutuar, sepse po është vetëm informatë dhe nuk po mundemi me ndikuar asgjë. Andaj, kishte qenë mirë secili nga ne me hulumtuar nga pak në terren dhe me pa çka mundemi me bërë në aspektin e zhvillimit të kulturave të ndryshme të sistemit të ujitjes, granateve, të subvencioneve, me pasur informata më shumë edhe me përgatitur një raport me ia prezantuar kryetarit dhe drejtorit, që ai me pasur parasysh për të ardhmen me iu përshtatur kësaj agjente. Mendoj se ky është qëllimi i Komitetit, se nuk kemi mundësi me bërë diçka pasi nuk jemi ekzekutiv, por më tepër organ këshilldhënës dhe kontributi ynë duhet trajtuar në këtë aspekte.

**Rashit Gashi** tha se përvoja ime është e vogël në këtë fushë, kështu që besoj se Feimi prej këndit edhe të VV-së si grup dhe të përvojës në atë zonë do të kontribuoj më tepër, se mundësitë janë më të kufizuara prej zonës nga vijë unë, nga zona e Gollakut, por do të angazhohem më shumë, në mënyrë që t'i shoh kërkesat, nevojat e banorëve në këtë anë.

**Driton Rukiqi** u shpreh se, siç e ceku edhe kolegu Rashiti, ne në kuptimin e përvojës nuk e kemi, por e kemi vullnetin dhe do të angazhohemi në kuptimin e politikëbërjes dhe të ndihmës sa më të madhe të dikasterit të bujqësisë, siç e ceku edhe kryesuesi, me pasur një takim me Drejtorinë e Bujqësisë, t'i ndihmojmë Drejtorisë sa të kemi mundësi dhe potencial, se dihet që bujqësia është fusha më e rëndësishme.

**Muhamet Selmani, kryesues,** tha se është mirë që secili prej nesh me parë ndonjë ekspert të fushave të bujqësisë dhe ia vlen me bërë një listë të tyre, që ne mundemi me u konsultuar me ta. Me bërë një listë të fushave të bujqësisë dhe me i ndarë prioritetet e fushave të bujqësisë që ne duhet angazhuar.

Pasi ta përpilojmë listën, me bërë një plan për takim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe me u koordinuar për këto çështje.

**Feim Osmani** tha se ne duhet me u takuar me Drejtorinë, me na treguar neve planin, mos me bërë angazhime të dyfishta, që me ditur çka kanë plan, p.sh. për Gollak, për pjesë e rrafshit, me ia dhënë idetë tona e mbas atij takimi e shohim si e mbulojmë edhe në aspektin gjeografik dhe në aspektin e fushave të kulturave të ndryshme, se tani jemi të fokusuar më tepër në këtë pjesën e rrafshit e mundemi me lënë keq këtë pjesën e Gollakut.

**Muhamet Selmani, kryesues,** e mori për obligim me njoftuar drejtorinë për konstituimin e Komitetit dhe me u takuar me drejtorin, për të marrë agjendën e tij për të koordinuar takimin. Pas takimit me Drejtorinë, ne duhet me u fokusua bashkërisht te buxheti për subvencion për bujqësi, p.sh. për vitin 2022 buxheti për bujqësi është 100 mijë euro.



**Feim Osmani** theksoi se ne duhet me u takuar me Drejtorinë dhe drejtori me na orientuar te ndonjë zyrtar që ka pasur informacione të vazhdueshme këto 5-6 vitet e fundit, që ne me ditur çka me bërë, çka nuk është realizuar dhe çka mundet mu realizuar. Sa u përket ekspertëve, unë e kam njoftuar drejtorin se ka qenë një djalë i mirë që ka punuar me Reisin në shumë programe në Komunë, andaj kishte qenë mirë drejtori me u angazhuar në Komitet.

**Kryesuesi** tha se kur vendosim me i takuar këta ekspertë, i thërrasim me bashkëbiseduar me ta, duhet me gjetur një formë, nëse dëshirojnë në baza vullnetare në rregull, nëse jo me gjetur mënyrën si mundemi me i angazhuar. Nëse e kemi listën e ekspertëve, ne mundemi me angazhuar ndonjë kompani.

**Feim Osmani** u shpreh se qëllimi im është me u angazhuar për bujqit e Prishtinës, nëse është nevoja edhe vullnetar punoj dy herë në javë me zhvillua bujqësinë e Prishtinës. Mendoj se Muhameti është njohës i fushës, së paku vjen nga një regjion dhe familje që e keni pasur traditë, kështu që besojmë unë dhe të tjerët, se do të kontribuojmë në këtë çështje.

**Muhamet Selmani, kryesues,** theksoi se jemi në fazën që duhet fokusim i madh. Shumë herë kam diskutuar me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Platorin, për këtë temë të bujqësisë, ku edhe ai është brengosur se Prishtina është larg me prodhime bujqësore, prandaj duhet me i ndarë donacionet nëpër territore dhe me i fokusuar donacionet me nxitur zonën, p.sh. zonën e Gollakut duhet me ditur me çka me nxitur.

**Feim Osmani** tha se kjo nuk ka me pasur efekt të shpejtë sa me treguar rezultate të shpejta, por me krijuar një metodologji të punës dhe një vullnet te bujqit.

**Muhamet Selmani, kryesues,** u shpreh se po e përmbledhim këtë takim së pari me u takuar me drejtorin për të marrë informacione, së dyti, me bërë një listë të ekspertëve që do të na ndihmonin dhe, së treti, na duhet me u fokusua pasi është buxheti për vitin 2023, ne duhet me iniciuar këtu te buxheti, te subvencioni i bujqësisë.

**Feim Osmani** shprehu mendimin se duhet shpejt me i identifikuar fushat se kemi me ardhur në diskutim publik kur të diskutohet për Drejtorin e Bujqësisë. Nëse nuk i kemi identifikuar fushat, nuk e dinë për afërsisht pse po i kërkon, p.sh. 1 milion euro buxhet dhe dalim keq, duhet me ditur pse e ke qëllimin për 1 apo 2 milion euro që po i kërkon.

*Mbledhja përfundoi në orën 10:40.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**



Faqe3nga3